

URDHËR
Nr. 234, datë 24.5.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të shkresës nr. 465/2 prot., datë 18.5.2022 “Kërkesë për miratimin e autorizimeve për lëvizjet e punonjësve jashtë qendrës së punës” nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë te drejtori i përgjithshëm, z.Ergys Qirici për dërgimin me shërbim brenda vendit jashtë qendrës së punës, të punonjësve të Ndihmës Juridike Falas.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja